



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 179, datë 29.04.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE
TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË
PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E
LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 123, NR. 125, NR. 127 DHE NR. 128,
DATË 01.04.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 123, nr. 125, nr. 127 dhe nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. Atalanta Zeqiraj - relator znj. Marçela Shehu
2. Për kandidaten znj. Flojera Davidhi - relator z. Ilir Toska
3. Për kandidaten znj. Rudina Palloj - relator znj. Marçela Shehu

3. Për kandidatin z. Genti Dokollari, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 127, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR